

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Dt. 18.07.2017

Për: Operatorin ekonomik Fjortës SH.P.K, me nr.Nipti J97426201K. Me adrese: Lagjja "Osman Haxhiu", Rruga "Demokracia", Objekt nr.1, VLORE.

Nga:Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlore Lagja Kushtrimi rruga Arkobaleno tel 033223849.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E hapur (me sistem elektronik).Nr.REF-16260-06-02-2017.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje karburanti (gazoil 10 ppm, naft D1) për vitin 2017  
Fondi limit: 26 756 376 (Njëzetë e gjashte milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashte mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashte) leke pa TVSh.

Sasia e karburantit: 177 890 (njëqind e shtatëdhjetë e shtate mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) litra. Marzhi i fitimit: 10%. Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve.

Burimet e financimit : Sh.A Ujësjetllës-Kanalizime Vlore.

Afati i mbarimit të kontratës: Nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në 12 (dymbëdhjetë muaj).

Data e zhvillimit të tenderit: dt.03.07.2017 ora 10:00. Vendi: Në faqen zyrtare të web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, sipas raportit përfundimtar, të KVO-s, miratuar nga Titullari i AK, kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi këta ofertues:

1. "A&T sh.a dhe Sun Petroleum Albania shpk" me nr.nipti L32320008H dhe nr.nipti L32112012M me oferte ekonomike 8.3% (tete pik tre) marzhë fitimi i shprehur në %
2. "Eroil & Das Oil" me nr.nipti L32230076S dhe nr.nipti L52230020G me oferte ekonomike 10 % (dhjete) marzhë fitimi i shprehur në %.
3. "Fjortës shpk" me nr.nipti J97426201K me oferte ekonomike 7.2 % (shtate pik dy) marzhë fitimi i shprehur në %.

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **A&T dhe Sun Petroleum-** me nr.nipti L32320008H dhe nr.nipti L32112012M me oferte ekonomike 8.3 % (tete pik tre) marzhë fitimi i shprehur në % - **NUK KUALIFIKOHET** për arsyet e mëposhtme :

Operatorët ekonomik meqenëse kanë dorëzuar oferte të përbashkët, që kjo oferte të jetë e vlefshme duhet të dorëzonin:

- a) Marrëveshje e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomik është krijuar zyrtarisht;
- b) Prokura e posaçme.

Te dy operatorët ekonomik nuk kanë mundur dot të vërtetojnë këtë bashkim ekonomik ku do të përcaktohet dhe % e pjesëmarrjes së secilës pale në këtë procedurë, pasi nuk kanë dorëzuar dokumentet e mësipërm të cilët do ta bënin të ligjshëm këtë oferte, si e tillë oferta e tyre është e pavlefshme.

-operoret ekonomike A&T dhe Sun Petroleum nuk kanë mundur dot te plotësojnë piken 4) te kapacitetit ekonomik dhe financiar ku kërkohet: Vërtetim lëshuar nga Bashkia se i ka shlyer taksat vendore, për vitin 2016 dhe këstin e pare për vitin 2017, shoqëruar me faturën e pagesës se këtyre detyrimeve ne bank. Operoret ekonomik nuk e kanë shoqëruar vërtetimin e lëshuar nga Bashkia për shlyerjen e detyrimeve me faturat e pagesës se këtyre detyrimeve ne Bank.

2. **Eroil & Das Oil**- me nr.nipti L32230076S dhe nr.nipti L52230020G me oferte ekonomike 10% marzhë fitimi i shprehur ne % - **NUK KUALIFIKOHET** për arsyet e mëposhtme :

-bashkimi i operoreve ekonomik nuk ka mundur dot te vërtetojë piken 3 te kapacitetit ekonomik dhe financiar. Vërtetimi i gjendjes financiare te operoreve ekonomik nga një ose me shumë banka, lëshuar jo me vone se 5 dite përpara hapjes se ofertave. Vërtetimi i bankës se operatorit ekonomik Eroil mban datën 20.06.2017 ndërsa vërtetimi i bankës se operatorit ekonomik Das Oil mban datën 16.06.2017 ndërkohë qe ofertat janë hapur ne date 03.07.2017, pra vërtetimet nuk janë lëshuar jo me vone se 5 dite përpara hapjes se ofertave dhe si i tille ky kriter nuk është përmbushur ne përputhje me kërkesat për kualifikim te autoritetit kontraktor.

-bashkimi i operoreve ekonomik nuk ka mundur dot te vërtetojë piken e) te kriteret e veçanta te kualifikimit ku kërkohet: një vërtetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te ujit te pijshëm te kontratave te ujit te pijshëm qe ka operatori ekonomik për pikat e shpërndarjes se karburantit, ne qytetin e Vlorës. Për përmbushjen e këtij kriteri bashkimi i operoreve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument për te vërtetuar shlyerjen e detyrimeve.

-bashkimi i operoreve ekonomik nuk ka mundur dot te vërtetojë piken d) te kriteret e veçante te kualifikimit ku kërkohet: një vërtetim qe konfirmon shlyerjen e te gjithë detyrimeve te maturuara te energjisë elektrike te kontratave te energjisë qe ka operatori ekonomik i regjistruar ne Shqipëri. Operatori ekonomik Eroil ne baze te kontratës se qerese qe ka me qeradhënësin Erjon Stojku pasi vet nuk rezulton i regjistruar ne sistemin e OSHEE, Vërtetimi i OSHEE i paraqitur nga operatori ekonomik ne emrin e qera dhënësit Erjon Stojku nuk përfshin muajin maj 2017 detyrimi te cilit e ka afatin e fundit te matuar deri ne 30.06.2017. duke qene se kjo procedure zhvillohet ne dt.03.07.2017 operatori ekonomik duhet te kishte paguar faturën e muajit maj 2017 për te qene i vlefshëm si vërtetim për këtë procedure.

Ndërsa operatori tjetër ekonomik Das Oil nuk ka paraqitur asnjë vërtetim nga OSHEE për shlyerjen e detyrimeve te maturuara te energjisë elektrike.

Operatori ekonomik Das Oil nuk ka paraqitur :

- mungon Deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike

- mungon Deklarate mbi konfliktin e interesit

- mungon Vërtetim se ka shlyer taksat vendore për vitin 2017, shoqëruar me faturën e pagesës se këtyre detyrimeve ne bankë.

-mungon bilanci i certifikuar i viti 2014 dhe vitit 2015

-mungon licenca nga qendra kombëtare e licencimit QKL.

-bashkimi i operoreve ekonomik nuk ka mundur dot te vërtetojë piken 4 te kapacitetit teknik ku kërkohet qe: operatori ofertues te disponoje minimumi 3 (tre) pika shpërndarje te karburantit brenda territorit te Bashkise Vlore, ku te jete përcaktuar adresa e sakte. Operoret ofertues kane paraqitur dokumentacion vetëm për një pike shpërndarje brenda territorit te Bashkise Vlore dhe jo 3 nga sa janë kërkuar, pra si i tille ky kriter quhet i paplotësuar.

Është kualifikuar ne këtë procedure prokurimi operatori ekonomik:

- “Fjortes shpk” me nr.nipti J97426201K me oferte ekonomike 7.2 % (shtate pik dy) marzhë fitimi i shprehur ne %, **KUALIFIKOHET.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi është paraqitur në tender me te gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentet Standarde te Tenderit.

VO: Anëtari i Komisionit te Vlerësimit te Ofertave Altin Kulla ka shprehur mendim ndryshe ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Fjortes ShPK për arsyet e mëposhtme: operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vërtetojë piken d) te kriteret e veçanta te kualifikimit ku kërkohet: një vërtetim qe konfirmon shlyerjen e te gjithë detyrimeve te maturuara te energjisë elektrike te kontratave te energjisë qe ka operatori ekonomik i regjistruar ne Shqipëri. Vërtetimi i OSHEE i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përfshin muajin maj 2017 detyrimi te cilit e ka afatin e fundit te matuar deri ne 30.06.2017. duke qene se kjo procedure zhvillohet ne dt.03.07.2017 operatori ekonomik kishte detyrimin për te paguar faturën e muajit maj 2017 për te qene i vlefshëm si vërtetim për këtë procedure.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Fjortes”SH.P.K, me nr.Nipti J97426201K. Me adrese: Lagjja “Osman Haxhiu”, Rruga “Demokracia”, Objekt nr.1, VLORE, se oferta e paraqitur me marzhë fitimi ne vlerën 7.2 % është identifikuar si oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Vlore Lagj :Kushtrimi Rruga : Arkobaleno, ne numrin e kontaktit 0692539127 sigurimin e kontratës, dhe dokumentet e tenderit siç parashikohet në DST, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Se bashku me sigurimin e kontratës duhet te sillni ne forme te listuar te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe behet pjese e dosjes se tenderit.

Dokumentacioni i listuar, duhet te jete i futur ne një zarf te mbyllur dhe i vulosur me vulën e operatorit (subjektit). Zarfi i dokumentacionit te tenderit duhet te paraqitet nga përfaqësuesi ose i autorizuari ne sekretarin e ndërmarrjes për tu protokolluar.

Nëse dokumentacioni i tenderit, pas verifikimit rezulton i rregullt, atëherë do te procedohet brenda afateve ligjore me nënshkrimin e kontratës nga përfaqësuesit e te dy palëve.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe AK do te procedoje siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.07.2017

Ankesa: ka ose jo. JO (nuk ka patur ankesa ne këtë procedure prokurimi).

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor] Dorian Xhelili